

## NË EMER TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEGA SUHAREKË**, Gjyqtari Qemail Suka, me pjesëmarrjen e Sek. Juridike Vjollca Haziraj, në lenden penale sipas P.Th.nga Prizreni Aktakuzës **PP.nr.1008/15 të dt 12.05.2016**, ndaj të akuzuarit I. A. L. nga fsh B. Komuna Suharekë, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KP-së, në prezencë të prokurorit të PTH-ës nga Prizreni Musli Gashi, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij Av.S. S., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt. 18.10.2017 mori publikisht shpalli dhe me date 20.10.2017, përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

**I akuzuari** I. L., nga i ati A. , e ëma L. , i lindur me dt. 23.10.1994, në fsh. B. ku dhe tani jeton, me numër personal ....., i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa dënuar me parë, shqiptar, shtetas e Republikës së Kosovës.

### Ë S H T Ë F A J T O R

Se me date 05.04.2015 rreth orës 09:15 minuta, në fsh.B. K. Suharekës, nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë si pjesëmarrës në komunikacionin rrugor, duke drejtuar automjetin e udhëtareve të markës “BMW” me targa të regjistrimit 04-...-EN, vepron në kundërshtim me nenin 54 dhe 126 të LSKRR-se, në atë mënyrë që nuk ia përshtat shpejtësinë e lëvizjes së automjetit kushteve, gjendjes dhe rrethanave të rrugës dhe nuk bën distancën e mjaftueshme të sigurisë të sigurisë ndaj automjetit i cili lëvizte para tij, godet nga mbrapa automjetin e markës “O. V.” me targa të regjistrimit 04-...-AS, të cilën e drejtonte i dëmtuari Sh. E., i cili në atë moment ishte i ndalur në kolonë, ku si pasojë pas dëmeve materiale në automjete, lëndime të lehta trupore pësojnë Sh. E. dhe atë: kontuzion të qafës dhe reaksion stresogjen, ndërsa N. E.: gjendje paskontuzive në unazat e qafës dhe stresit pastrumatik.

**Me këtë ka kryer veprën penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KP-se.**

Andaj gjykata në kuptim të nenit 41,51,52, 73,74 KP si dhe 359 parag. 1 dhe 2,dhe neni 378 KPK-ës të akuzuarit, i shqipton :

### D Ë N I M M E G J O B Ë

Në shumë prej 150 (njqindpesedhjetë) € , të cilin denim duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, prej ditës së plotefuqishmerisë së këtij Aktgjykimi. Nëse i akuzuari denimin në të holla nuk e paguan në afatin e parapare, Gjykata denimin me gjobe do të ia zëvendësoi me denim me burg në kohezgjatje prej 7 ditësh, duke e llogaritur me nga 20 € për çdo ditë burgimi.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve mjeko-ligjore të paguaj 20 euro, ekspertizës së komunikacionit në shumë prej 40.88€ dhe paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € në afat prej 15 ditësh pas plotefuqishmerisë së këtij Aktgjykimi.

Udhëzohet pala e dëmtuar, Sh. D. E. nga fsh.Sh. K.Suhareke dhe N. J. E. nga fsh.S. K.Suhareke që kërkesën pasurore-juridike ta realizojë në kontest të rregullt civil.

## **A r s y e t i m**

PTH-e me aktakuzë **PP.nr. 1008/15 të dt 12.05.2016** e ka akuzuar I. A. L. nga fsh B. Komuna Suharekë, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KP-së, të cilin gjatë seancës së shqyrtimit fillestare e ka përfaqësuar PSH nga Prizreni Musli Gashi, i cili në tërësi ngel pranë të dhënave si në aktakuzë, që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata në shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e të akuzuarit ka vërtetuar këtë gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 të KPP-ës në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë të pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit, është bërë vullnetarisht në shqyrtimin fillestar, pranimi është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuzën, të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe provat materiale të paraqitura ndaj të akuzuarit nga ana e PTH-ës në Prizren.

Gjykata po ashtu në tërësi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë në shqyrtimin fillestar nga ana e të akuzuarit, është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248 të KPP-ës, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsyet dhe kushtet për hüdhen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte të cilat i përmbanë aktakuzën, Gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KP-së, andaj Gjykata ka vendosur të akuzuarin ta shpall fajtor dhe t'ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KP-ës, të cilat ndikojnë në lartësinë e dënimin.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për bazë se i akuzuari ka pasur qëndrim korrekt ndaj Gjykatës, ka bërë pranimin e fajësisë në mënyrë vullnetare, është penduar për veprën e kryer, është hera e parë që bie ndesh me Ligjin.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori në kuptim të nenit 463 të KPP-ës. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u mori në kuptim të nenit 452 paragrafi 1 të KPP-ës.

### **GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA SUHAREKE**

**Gj y q t a r i**  
**Qemal Suka**

**KESHILLE JURIDIKE**: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.